



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 517/8 prot.

Tiranë, më 26.09.2022

VENDIM

Nr. 909, Datë 26.09.2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SAUBER HOLDING AG NGA SHOQËRIA AUDI ACTIENGESELLSCHAFT”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.09.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Sauber Holding AG nga shoqëria AUDI Aktiengesellschaft.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Sauber Holding AG nga shoqëria AUDI Aktiengesellschaft.

VËREN SE :

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Sauber Holding AG nga shoqëria AUDI Aktiengesellschaft.

Referuar “Marrëveshjes për blerjen e aksioneve”, palët në transaksion janë:

**Blerësi:** AUDI Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e mjeteve motorike dhe automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, aksesorëve të tyre dhe të gjitha makinerive, veglave dhe artikujve të tjerë teknikë.

AUDI Aktiengesellschaft është një filial i zotëruar plotësisht nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

*Porsche Leasing SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

*Porsche Albania SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

**Shitësi:** Islero Investments AG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, me objekt aktiviteti: blerja, mbajtja, administrimi dhe shitja direkte ose indirekte e pasurive të paluajtshme në shoqëri vendase dhe të huaja; kryen transaksionet tregtare dhe financiare që drejtpërdrejt ose tërthorazi, plotësisht ose pjesërisht, lidhen me qëllimin e shoqërisë ose mund të lehtësojnë realizimin e saj.

Islero Investments AG zotërohet nga Ridgeback Establishment AG, shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, e cila kontrollohet nga Fondacioni Barchetta. Fondacioni Barchetta menaxhohet, kontrollohet dhe përfaqësohet vetëm nga bordi i saj.

Islero Investments AG, Ridgeback Establishment AG dhe Fondacioni Barchetta nuk kanë filiale dhe nuk kanë gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2021.

**Target:** Sauber Holding AG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, me objekt aktiviteti: investimin në shoqëri të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit dhe financimi i tyre. Shoqëria mund të krijojë degë ose filiale dhe të kryejë të gjitha transaksionet që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me qëllimin e saj etj.

Sauber Holding AG zotërohet 100% nga Islero Investmens AG.

Sauber Holding është aksionari i vetëm i shoqërive Sauber Motorsport AG dhe Sauber Technologies AG, shoqëri të organizuara dhe ekzistuese sipas ligjeve të Zvicrës. Sauber Motorsport AG menaxhon dhe drejton ekipin e garave të Formula 1 Alfa Romeo F1 Team Orlen. Sauber Technologies AG është aktive në aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit të Motorsportit dhe ofron ekspertizë të nxitur nga Formula 1 në inxhinieri, prodhim dhe aerodinamikë për palët e treta.

Sauber Holding AG nuk është prezente dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

### **Përqendrimi**

Më datë 8 korrik 2022, shoqëritë AUDI Aktiengesellschaft” (blerësi) dhe Islero Investments AG (shitësi) kanë nënshkruar “Marrëveshjen për blerjen e aksioneve” lidhur me shitjen dhe blerjen e 75% të aksioneve në shoqërinë target Sauber Holding AG dhe “Marrëveshjen e aksionarëve”, e cila do të rregullojë të drejtat dhe detyrimet e palëve si aksionarë të shoqërisë.

Referuar Marrëveshjes për blerjen e aksioneve, shitësi synon ti shesë blerësit, në dy faza, 75% të aksioneve, që përfaqësojnë 75% të kapitalit themeltar dhe të të drejtave të votimit të bashkangjitura me aksionet.

Në fazën e parë shitësi do t’i transferojë blerësit 24.9% të aksioneve, ndërsa në fazën e dytë 50.1% të aksioneve. Pas përfundimit të transaksionit, AUDI Aktiengesellschaft do të zotërojë 75% të aksioneve të target dhe Islero Investmens AG do të zotërojë 25% të aksioneve të target.

Transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **II. Vlerësimi i konkurrencës**

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve mbështetëse për garat e Formula 1, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Sauber Holding AG nga shoqëria AUDI Aktiengesellschaft. Pas implementimit të transaksionit, target do të zotërohet 75% nga AUDI Aktiengesellschaft dhe 25% nga Islero Investments AG.

AUDI Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, aktive kryesisht në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shitjes së mjeteve motorike dhe automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve dhe një filial në pronësi të Volkswagen AG, pjesë e Volkswagen Group. Grupi Volkswagen është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Albania SHPK, të cilët operojnë në tregun e shitjes së makinave dhe në tregun e qerasë financiare e sigurime.

Sauber Holding AG, është një shoqëri HOLDING, e cila e kryen aktivitetin nëpërmjet dy filialeve të saj, Sauber Motorsport AG dhe Sauber Technologies AG në fushën e aktiviteteve mbështetëse për automjetet që konkurrojnë në Kampionatin Botëror të FIA Formula 1. Sauber Holding AG nuk është prezente dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

**PËR KËTO ARSYE:**





Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,


**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Sauber Holding AG nga shoqëria AUDI Aktiengesellschaft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Leida MATJA</b> (  ) Zv/Kryetar	<b>Rezana KONOMI</b> (  ) Anëtar	<b>Adriana BERBERI</b> (  ) Anëtar	<b>Durim KRAJA</b> (  ) Anëtar
--	--	---	--

**Dënar BIBA**  
()  
Kryetar

